03-200-60604
17.07.2025

**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E GJILANIT**

**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

ZYRA E KRYETARIT

KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

| | |
|---|---|
| Data/Date/Datum: | 14.07.2025 |
| Për/To/Za: | Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) |
| Nga/From/Od: | Arbenita Sopi Haziri – Kryesuese e Komisionit për Hartimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit |
| Përmes/Through/Preko: | Alban Hyseni - Komuna e Gjilanit |
| Lënda/Subject/Tema: | Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës për Vitin 2024 |

Të nderuar/a,

Bazuar në Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit për vitin 2024, brenda afatit të përcaktuar sipas Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 23, paragrafi 5, ju lutem gjeni të bashkangjitur Planin e Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit për Vitin 2024, të përgatitur nga Komisioni i themeluar sipas Vendimit me nr.02/981, të dt.07.07.2025.

Me respekt,

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

**ZYRA E KRYETARIT**
**KANCELARIJA PRESEDNIKA/MAYOR'S OFFICE/BASKAN OFISI**

**PËR:**
Zyra Kombëtare e Auditimit

**NGA:**
Alban Hyseni
Kryetar i Komunës së Gjilanit

**LËNDA:**
Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës për Vitin 2024

Gjilan,
Korrik, 2025

| Nr | Gjetja/Çështja | Rekomandimi | Veprimet e planifikuara | Zyrtari\ët përgjegjës | Data e planifikimit të zbatimit të rekomandimit |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Çështja A1 - Mbivlerësimi i detyrimeve (faturave) të pa paguara. | Kryetari, duhet të forcoj kontrollet e brendshme për të siguruar se janë ndërmarrë veprime për adresimin e shkaqeve që kanë ndikuar në mbivlerësimin e detyrimeve të pa pagua | 1.Do të bëhet verifikimi i të gjitha detyrimeve të papaguara.<br>2. Veprim tashmë i ndërmarrë është nxjerrja e Urdhëresës, me datë 18.06.2025, për mos futjen e pro-faturave në E-financa. | Zyrtarët Financiar, Drejtoritë përkatëse. | Gjatë gjithë kohës deri më 15 janar 2026 |
| 2 | Çështja A2 - Mos regjistrimi i pasurisë mbi 1000€ në regjistrin e pasurive në SIMFK | Kryetari duhet të sigurojë se do të përmirësoj kontrollet lidhur me regjistrimin e pasurive që të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar në regjistra përkatës, të bëhet azhurnimi i regjistrave kontabël të pasurive përpara përgatitjes së pasqyrave financiare si | Do të shtohen kontrollet lidhur me regjistrimin e pasurive që të gjitha pasuritë e Komunës të jenë të regjistruara në regjistrat përkatës. | Zyrtarët e pasurisë | TM3 dhe TM4 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe të shpalosen saktë në PFV. | | | |
| 3 | Çështja B1 - Keqklasifikim i shpenzimeve | Kryetari duhet të sigurojë që në koordinim me Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i transaksioneve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate. | 1. Do të sigurojmë planifikimin e fondeve për obligimet sipas kategorive ekonomike adekuate.<br>2. Në koordinim me Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve do të sigurohemi që shpenzimet të bëhen nga kategoritë ekonomike adekuate. | Drejtori për Buxhet dhe Financa,<br>Kryetari i Komunës,<br>Zyrtarët e financave. | TM3 dhe TM4 |
| 4 | Çështja A3 - Zhvillimi i procedurës së prokurimit në kundërshtim me kërkesat ligjore | Kryetari duhet të siguroj se procedura e prokurimit do të zhvillohet në pajtim me kërkesat e Ligjit të prokurimit publik, dhe kur autoriteti kontaktues nuk i di sasitë indikative me çmim për njësi atëherë nuk duhet te përfshihet në kontratë edhe devijimi +/- 30%. | Udhëheqësi i zyrës së prokurimit do të shtoj mbikëqyrjen dhe kujdesin që procedurat e prokurimit të zhvillohen në pajtim me Ligjin e prokurimit publik. | Zyra e prokurimit | TM3, TM4 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Çështja B2 - Pagesa e projekteve në kundërshtim me ligjin e buxhetit. | Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestinim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet përmes procedurave të përcaktuar me rialokim në pajtim me Ligjin mbi ndarjet buxhetore. | 1. Do të hartojmë procedurën e brendshme për menaxhimin dhe rishikimin e fondeve për projekte dhe do të mbajmë koordinim të rregullt me MF-në.<br>2. Do të ndërmarrim veprimet e duhura në zbatim të kornizës ligjore mbi ndarjet buxhetore, që projektet e planifikuara të realizohen sipas planit. | Zyra Prokurimit,<br>Drejtoria e Financave,<br>Kryetari i Komunës. | TM3 dhe TM4 |
| 6 | Çështja B3 - Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara dhe shpenzimet gjyqësore/përmbarimore. | Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, në mënyrë që ti shmanget shpenzimeve shtesë të interesit dhe kamatës. | Do të shtojmë mbikëqyrjen në menaxhimin e fondeve për të shlyer obligimet me kohë dhe për të shmangur shpenzimet shtesë të interesit dhe kamatës. | Zyrtari Kryesor Financiar,<br>Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë | TM3 dhe TM4 |
| 7 | Çështja B4 - Vonesa në vlerësimin e tenderëve | Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në mënyrë që komisioni vlerësues të kryejë | 1.Komisionet do të njoftohen për afatin kohor të vlerësimit të tenderëve. | Zyra e Prokurimit | TM3 dhe TM4 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | vlerësimin e tenderëve brenda afatit 30 ditorë. | 2.Në raste të vonesave do të njoftohet kryetari për ndërmarrjen e veprimeve për respektim të afateve | | |
| 8 | Çështja B5 - Angazhimi i punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta pa procedura ligjore | Kryetari të sigurojë se me rastin e angazhimit të personave me marrëveshje për shërbime të veçanta, të respektohen kriteret sipas legjislacionit përkatës. | Do të plotësohen pozitat përmes procedurave të rregullta të rekrutimit dhe prokurimit duke respektuar legjislacionin përkatës. | Zyra e Personelit<br><br>Zyra e prokurimit | TM3-TM4 |
| 9 | Çështja B6 - Mos verifikimi i plotë i pronave komunale | Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë. | Pas plotësimit të vendeve të punës me staf të nevojshëm, trajnimit dhe pajisjes së stafit me teknologji të nevojshme do të shtojmë angazhimin që të arrijmë verifikimin e 20% të pronave të paluajtshme për vitin 2025. | Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe<br><br>Udhëheqësja e Zyrës së Tatimit në Pronë | TM3 dhe TM4 |
| 10 | Çështja A4 - Mos raportimi i rregullt për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale | Kryetari duhet të sigurojë se në Kuvendin Komunal dorëzohen raporte të rregullta gjashtë (6) mujore. Ato duhet të përmbajnë edhe raportimin e veçantë | Hartimi i një formati standard për raportim dhe përcaktimi i afateve fikse për dërgim në Kuvend. | Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë. | TM3 dhe TM4 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, si dhe përmbushjen e planeve për dhënie të pronave në shfrytëzim. | | | |
| 11 | Çështja A5 - Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara | Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit së pari të sigurohet buxhet i mjaftueshëm për financimin e projekteve. Po ashtu, duhet të siguroj që menaxherët e kontratave të mbikëqyrin realizimin e projekteve për të eliminuar të gjitha pengesat që e pamundësojnë realizimin e kontratës sipas kushteve të parapara. | 1.Verifikimi paraprak i mjeteve buxhetore para inicimit të prokurimit.<br>2.Mbikëqyrje e rregullt e zbatimit të Kontratave nga menaxherët përkatës. | Zyra e Prokurimit,<br>Drejtoria për Buxhet dhe Financa,<br>Kryetari i Komunës. | TM3 dhe TM4 |
| 12 | Çështja B7 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit | Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet | 1.Do të mbajmë takime të rregullta, dy herë në muaj me menaxherë të kontratave për zbatim të rekomandimit dhe përditësim të regjistrave | Zyra e Prokurimit<br>Zyrtari përgjegjës | TM3 dhe TM4 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | nga sistemi elektronik i prokurimit publik. | përmes platformës së e-prokurimit.<br>2. Caktimi i zyrtarit përgjegjës që mbikëqyr zbatimin dhe asiston në përdorim të sistemit elektronik e-prokurimi. | | |
| 13 | Çështja A6 - Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim | Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe trajtimin e duhur të projekteve që janë në proces ose të pezulluara. | 1.Zyrtari i pasurisë ka sistemuar të gjitha projektet që janë në proces apo ju mungon dokumentacioni i pranimit teknik, duke i evidentuar në një regjistër në formatin Excel.<br>2.Ky raport do të përditësohet në vazhdimësi dhe do të trajtohet me përgjegjësit: menaxherët e projekteve dhe komisionet e pranimeve teknike. | Zyrtari i pasurisë,<br>Menaxherët e kontratave<br>Komisionet e pranimeve teknike<br>Drejtorët e Drejtorive | TM3 dhe TM4 |
| 14 | Çështja B8 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme | Kryetari duhet të marrë masat për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse, me qëllim të | 1. Do të marrim masat e nevojshme në zbatim të mekanizmave të vendosur me ligj dhe rregullore, për të | Kryetari i komunës,<br>Drejtori i Drejtorisë | TM3 dhe TM4 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | sigurimit të një menaxhimi më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme. | siguruar menaxhim më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.<br><br>2.Në draft-rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës, e cila më datë 03.07.2025 është miratuar në Kuvendin Komunal, është paraparë që në Zyrën e Tatimit në Pronë të angazhohen edhe dy zyrtarë për mbledhje të detyrueshme të tatimeve, duke kompletuar kështu stafin e nevojshëm. | për Buxhet dhe Financa dhe<br><br>Udhëheqësja e Zyrës së Tatimit në Pronë | |

Datë: 14.07.2025

Gjilan

Kryetari i Komunës:

Alban Hyseni